



POLITIKA E CILESISE

SIPAS ISO 45001:2018

Version: 02
Data Efektive:
01.10.2024

OBJEKTIVAT DHE PARIMET E SHENDETIT DHE SIGURISE NE PUNE

Objektivat dhe parimet e Politikës së Shëndetit dhe Sigurisë në Punë janë:

- Të krijojë dhe mirëmbajë një Sistem të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë i cili plotëson kërkesat e ISO 45001: 2018, të gjitha kërkesat ezbatueshme ligjore dhe rregullative, praktikat më të mira të industrisë dhe çdo kërkesë tjetër specifike të klientit.
- Të mirëmbahen vendet e punës për të siguruar që ato janë të sigurta dhe pa rreziqe ambientale e shëndetësore, duke përfshirë mjetet e hyrjes dhe daljes, me pajisje dhe rregullime të përshtatshme për mirëqenien e punonjësve.
- Të sigurojë dhe mirëmbajë ambiente pune dhe sisteme të sigurta të punës për punonjësit që janë të sigurt dhe të parrezikuar nga rreziqet shëndetësore.
- Të sigurojë dhe mirëmbajë impiantet, pajisjet dhe kontrollet operationale që parandalojnë dëmtimet.
- Të garantohet siguria dhe mungesa e rreziqeve shëndetësore në lidhje me përdorimin, trajtimin dhe ruajtjen e produkteve.
- Të konsultohet me punonjësit për çështje që lidhen me shëndetin dhe sigurinë nëpunë.
 - Të promovojë dhe inkurajojë një kulturë pozitive të shëndetit dhe sigurisë në të gjithë kompaninë përmes ofrimit të informacionit, trajnimit, udhëzimit dhe mbikëqyrjes.
 - Të sigurojë informacion, udhëzime, trajnime dhe mbikëqyrje të mjaftueshme përtë mundësuar punonjësit të shmangin rreziqet dhe të kontribuojnë pozitivisht në shëndetin dhe sigurinë e tyre dhe të tjerëve gjatë punës.
- Të kontribuojë sadopak në përmirësimin ndaj ndryshimeve klimatike, nëpërmjet plotësimit të kërkesave të nevojshme mbi mbrojtjen dhe uljen e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë, gjatë proceseve të ndryshme të punës në kompani.
- Të vendosi e rregullat efektive për tërheqjen e Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë në vëmendjen e punonjësve në mënyrë që ata të jenë të vetëdijshëm për detyrimet e tyre.



POLITIKA E CILESISE

SIPAS ISO 45001:2018

Version: 02
Data Efektive:
01.10.2024

- Të sigurojë që të gjithë punonjësit janë të vetëdijshëm për detyrimet e tyre individuale të Shëndetit dhe Sigurisë në punë sipas Ligjit për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë etj. Menaxhimi i larte do të kërkojë mbështetjen dhe bashkëpunimin e punonjësve në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë.
- Të përdorë një kulturë “faji të balancuar” përmes së cilës punonjësit inkurajohen haptazi të raportojnë rreziqet, përfshirë edhe ato që mund të kishin ndodhur për pak, pa frikën e hakmarrjes për të siguruar identifikimin e shkaqeve rrënjësore të aksidenteve duke bërë të mundur krijimin e masave për të eliminuar përsëritjen.
- Të sigurojë burime të mjaftueshme financiare dhe fizike që janë në dispozicion për të përmbushur objektivat e Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, si dhe të gjitha kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative.
- Të sigurojë vendosjen, monitorimin dhe rishikimin e objektivave të shëndetit dhe sigurisë në punë në intervale të rregullta.
- Të ruhet përmirësimi i vazhdueshëm i menaxhimit dhe performancës së shëndetit dhe sigurisë në punë duke monitoruar dhe rishikuar rregullisht Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në punë për të siguruar efektivitetin e tij.
- Të azhurnojë operacionet në përgjigje të përparimeve në teknologji, ndryshimeve në praktikën më të mirë të industrisë dhe kuptimit të ri në shëndetindhe sigurinë.
- Të sigurojë që vlerësimet e rrezikut janë duke u kryer në vazhdimësi, me punonjësit që marrin pjesë në procesin e vlerësimit të rrezikut. Vlerësimet do të mbulojnë dhe do të ndihmojnë në identifikimin e rreziqeve dhe vendosjen e objektivave me përparësi për eliminimin dhe zvogëlimin e rrezikut.
- Të rregullohet planifikimi, organizimi, kontrolli, monitorimi dhe rishikimi efektiv i masave parandaluese dhe mbrojtëse.
- Të mbajë shënime si prova objektive për të treguar pajtueshmërinë me Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë.



POLITIKA E CILESISE SIPAS ISO 45001:2018

Version: 02
Data Efektive:
01.10.2024

PËRGJEGJËSIA

Menaxheri ka përgjegjësinë e përgjithshme për Politikën e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë dhe Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë duke përfshirë formulimin, zhvillimin, zbatimin dhe angazhimin inkurajues nga personeli në të gjitha nivelet e kompanisë. Përfaqësuesit e Menaxhimit të emëruar në Manualin e Sistemit të Menaxhimit të Integruar janë përgjegjës për koordinimin, zbatimin dhe monitorimin e politikës në të gjithë kompaninë.

Të gjithë punonjësit, kontraktorët dhe vizitorët janë përgjegjës për zbatimin e politikave duke bashkëpunuar, duke marrë pjesë dhe duke kontribuar në suksesin e saj përmes veprimeve dhe sugjerimeve të tyre.

KOMUNIKIMI

Kjo Politikë e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë u komunikohet të gjithë punonjësve, kontraktorëve dhe vizitorëve.

Një kopje publikohet në tabelat e njoftimeve të punonjësve në Prodhim në ambientet e brendshme të ndërmarrjes. Të gjithë punonjësit inkurajohen ta lexojnë atë dhe t'i komunikojnë çdo pyetje një drejtori.

Kopjet u vihen në dispozicion palëve të interesuara sipas kërkesës dhe një kopje publikohet në faqen e internetit të kompanisë.

Administratori

Zamir DURBAKU

